

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor

Një udhërrefyes praktik për përdorues¹

Baza ligjore

Korniza Aftatmesme e Shpenzimeve (KASH) është dokumenti kryesor i planifikimit për politikat ekonomike të qeverisë. Qeveria e Kosovës përgatit KASH në përputhje me vizionin e zhvillimit kombëtar, i cili përfshin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; zhvillimin e kapitali njerëzor; dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.² Qeveria e Kosovës duhet të integroj gjininë në planifikimin, implementimin dhe monitorimin e implementimit të të gjitha ligjeve, strategjive dhe politikave si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjnore.³ Kjo përfshin edhe proceset buxhetore. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor (BPGJ) prezanton një qasje përmes të cilës perspektiva gjnore mund të integrohet në proceset buxhetore.


Pse Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor është i rëndësishëm?

BPGJ përfshin një proces përmes të cilit qëllimet strategjike drejt përforcimit të barazisë gjnore mund të prezantohen në buxhet. Kjo mund të rris transparencën, efektivitetin e shpenzimeve publike, dhe të ndëmjetësoj monitorimin e implementimit. Procesi i analizës së BPGJ mund të ndihmoj për të kuptuar nëse gratë dhe burrat, ose grupe të ndryshme të burrave dhe grave përfitojnë nga shpënzimet publike; sa efektive janë alokimet buxhetore në adresimin e nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave; sa efektiv është implementimi i politikave dhe buxhetit në arritjen e qëllimeve gjnore; dhe sa mund të ndikoj (pa)barazia gjnore në arritjen e këtyre qëllimeve. Për më tepër, departamentet buxhetore dhe institucionet në nivel komunal dhe kombëtar mund të përdorin BPGJ për të komunikuar dhe mbështetur nevojat e departamenteve tek institucionet apo akteret e tjerë, përfshirë këtu edhe Ministrinë e Financave.

Qasja e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjnor⁴

BPGJ mund të implementohet në një qasje të thjeshtë me tre hapa, përmes të cilës perspektiva gjnore mund të përfshihet në proceset dhe dokumentet buxhetore (shih Figurën 1).

Figura 1: Qasja me tre hapa drejt BPGJ



Në hapin 1, analiza BPGJ, ka për qëllim të kuptoj ceshtjet dhe hapësirat gjnore. Figura 2 nënvizon aspektet themelore për kryerjen e kësaj analize.


¹ Ky udhërrefyes është zhvilluar nga Ada Shima dhe Nicole Farnsworth në Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), në bashkëpunim me Elisabeth Klatzer, eksperte ndërkombëtare, për të mbështetur institucionet e Kosovës në buxhetimin e përgjegjshëm gjnor. Për më tepër informacion ose asistencë në përdorim të këtij udhërrefyesi, luteni të na kontaktoni në info@womensnetwork.org ose 038 245 850.

² Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Korniza Aftatmesve e Shpenzimeve 2013-2015, Prishtinë, Prill 2012: në: <http://mf.rks-gov.net/Portals/0/Raporte%20dhe%20publikime/KASH/KASH%202013-2015%20aprovuar%20ne%20Qeveri%20ANGL.pdf>.

³ Republika e Kosovës, Ligji për Barazi Gjnore, Ligji 2004/2, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130510160346132.pdf>.

⁴ Kjo qasje bazohet në praktikat ndërkombëtare të BPGJ dhe është adoptuar për kontekstin e Kosovës nga Elisabeth Klatzer, eksperte ndërkombëtare, në bashkëpunim me RrGGK.

Figura 2: Kuptimi i Cështjeve Gjinore dhe Zhvillimi i Qëllimeve



Bazuar në analizën e situatës së grave dhe burrave në sektorët specifik, analizohet numri i përfituesve gra dhe burra në një program të caktuar (p.sh. nga shërbimet publike ose transferat) në departamentet apo projektet e ministrise dhe/ose komunës. Kjo ndihmon në identifikimin e dallimeve në mes numrit të përfituesve apo pjesëmarrësve gra dhe burra në programe të caktuara. Në hapin e rradhës identifikohen alokimet buxhetore dhe kostot për shërbimet e caktuara. Bazuar në këtë, mund të përlogaritet shuma e buxhetit të shpenzuar nga e cila kanë përfituar burrat dhe gratë. Ky mund të jetë themeli i analizës që nxjerr në pah nëse ka hapësira të dallueshme në shpenzimet që kanë ndikuar në rritjen e barazisë në mes grave dhe burrave. Tabela e mëposhtme ilustron një shembull se si mund të mbledhen të dhënat për përfituesit gra dhe burra dhe si të identifikohen hapësirat potenciale gjinore në alokimet buxhetore (shih Figurën 3). Mbledhja e të dhënave për vite të ndryshme ndihmon paraqitjen e ndryshimeve në numrin e përfituesve ndër vite.

Figura 3: Shablon për Analizën e Rasteve të BPGJ

Lloji i shërbimit apo transferës	Buxheti total	Numri total i përfituesve	Buxheti për kapita	Numri i përfituesve		Buxheti i shpenzuar për gra	Buxheti për capita gra	Buxheti i shpenzuar për burra	Buxheti për kapita burra
				gra	burra				
Shërbimi A									
Shërbimi B									
...									

Përpos analizës sasiore është e rëndësishme të identifikohen nevojat, interesat dhe prioritetet e grupeve të ndryshme të përfituesve, p.sh. duke i pyetur në grupe fokusi dhe pyetësorë. Gjithashtu, është e rëndësishme që në vlerësimin e programeve apo shërbimeve të përfshihen edhe përfituesit. Analiza duhet të bëjë kujdes në identifikimin e akterëve të përfshirë në vendim-marrjen për llojet e programeve dhe kush përfiton nga këto shërbime apo transfera.

Në Hapin 2 të qasjes BPGJ, bazuar në rezultatet e analizës, duhet të zhvillohen apo ndryshohen qëllimet dhe aktivitetet për të adresuar hapësirat e gjetura. Duhet gjithashtu të zhvillohen indikatorë në bazë të qëllimeve për barazi gjinore.

Hapi 3 i BPGJ hedh vemendjen në integrimin e perspektivës gjinore në proceset dhe dokumentet buxhetore. Kjo mund të bëhet si më poshtë:

1. Përgatit një paragraf që përshkruan rezultatet e analizës BPGJ, i cili përfshihet në KASH dhe/ose dokumente buxhetore;
2. Përcakto qëllimet dhe aktivitetet për përmirësimin e barazisë gjinore;
3. Përcakto indikatorët specifik për të matur progresin për arritjen e qëllimeve të përcaktuara për barazi gjinore;
4. Për më tepër: cdo indikatorë që ka të bëjë me njerëz duhet zbërthyer në gra dhe burra.